

MITOLOGJI POPULLORE JUGORE

Dr. MARTIN MATO

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Universiteti i Tiranës
martin.mato@unitir.edu.al

“Populli është arkivi, muzeu dhe biblioteka jonë”

ABSTRACT

The research of the Southern Albanian mythology remains an uncharted territory due to the considerable lack of documentation. The article outlines a popular mythological figure. The metacontext reconstruction method has been used for the folkloric texts' work. The paper aims to document its entirety by providing proof of the Arbëresh mythology continuum.

Keywords: Southern Albanian folk mythology, folk mythology of the Arbëresh, zana, zëra, zarazi

Kur mendojmë për një tekst mendja rend tek një tekst i shkruar, por një definicion i hapur për një tekst mund të jetë gjithçka nga i cili mund të nxirret informacion, përfshirë edhe hapsirën më të madhe atë të materialeve orale, të shkruara apo vizuale. Pra në rastin tonë ndeshemi me një tekst “të lidhur” në korsetën e këngës së kënduar në një tekst oral dhe më pas të sanksionuar në mënyrë shkrimore.

Ndër veçantitë e krijimeve gojore është që rrëfyesi nuk flet për dikë që dëgjon për herë të parë për atë çështje apo histori. Diçka dihet në mos e tëra ose “punohet” me “materiale” të njohura; kujtojmë këtu motivin e Odisesë në letërsinë gojore, që haset në folklorin ballkanik. Ndodh që shkohet deri aty sa në tekste të ndryshme disa elemente marrin edhe interpretime krejtësisht të reja, meqë janë bërë të painterpresetueshme

për një dëgjues të kohëve të vona por megjithatë nuk janë larguar nga “rrethina” e figurës bazë, për të cilën dikur kanë luajtur një rol të dorës së parë. Rrethinat krijojnë shtratin mbartës e garantues që kthehet në një bashkëpërcjellës deri në kohët moderne.

Në fokus të këtij shkrimi do të kemi një figurë mitologjike, “zërë/a -a-t” që haset në tekste këngësh të jugut dhe ndonjë figurë tjetër, por që në vetvete mbartin një shëmbëlltyrë mbarë shqiptare.

Marrim për shqyrtim këngën¹ me titull “Hanko kur bëre Alinë”. Në pamje të parë është një këngë me një relacion historik në të cilën i këndohet së ëmes së Ali Pashë Tepelenës. Në vargun e katërt hasim një shprehje në pamje të parë të rëndomtë “ndriti vendin vetëtime”. Por shprehjen “ndriti vendin” e gjejmë edhe në eposin e veriut.

Me tej në vargjet nga i pestë deri te i nëntë thuhet:

Po ti Hanko s’i dhe gjinë,
nuk e vure dot në sisë,
se ta rritën zotëritë
me ato zërat e malit
dhe me ujët e spitharit²

Duke ju kthyer edhe një herë mendimit të mëparshëm në klishe kemi “dhe gjinë” “e vure ... në sisë” për çudi edhe “rriten zotëritë”, këtu hasim një ndërkëmbim kuptimor se Muji ishte një çoban i zotërinjve. Kulmin koleksioni i togfjalëshave e arrin me vargun “me ato zërat e malit”. Këtë koleksion shprehjesh e hasim edhe në eposin e Veriut³. Ky togfjalësh jep dorë sepse pranë qëndron mali krahasuar me “zanat e malit”. Një komponente interesante është “uji” vetë në se e përqasim me “lugun e zanave”. Për të parë se çfarë konotacioni kuptimor ka fjala “ujët e spitharit” duhet ta shpjegojmë se bëhet fjalë për një gropë në shkëmb ku mbledhet vetëm uji i shiut. Pra diçka e pastër dhe e kthjellët mund ti afrohej mjaft konceptit të “lugut të zanave”.

Në këngën “Kush u vra Korfuz përtej”⁴ i këndohet një heroi.

¹ Këngë popullore të Labërisë Mbledhës të folklorit 8 mbledhur e përgatitur nga Fatos Mero Rrapaj Tiranë 1991 kënga 673 faqe 748 kendum në Bëç-Tepelenë regjistruar më 1960

² Po aty. Kënga është marrë nga Bëç-Tepelenë viti 1960

³ “Epika Legjendare” f 104 rreshti 5 viti 1966 Tiranë marrë nga „ Visaret e kombit“ vëll II Tiranë 1937 kënduar nga Mhill Preka nga Curraj i Epër-Nikaj.

⁴ Kënga 670 “Kush u vra Korfuz përtej” faqe 745 mbledhur në Ramicë-Vlorë 1944-

Midis të tjerave në vargjet nëntë dhe dhjetë këndohet” mënga me tre palë flet/ ta ka qepur Zëra vetë.” Në fusnote mbledhësi shkruan: “Këmishë burrash që Isufit ia pati prerë e qepur e kunata, Zëra”. Këtu del mundësia që ky lloj emri të jetë përdorur si emër i përveçëm nga grate e zonës.⁵

Kënga 645 “Legjenda e urës së Kordhocës (Gjirokastrë).⁶ Në vargun e dhjetë deri dymbëdhjetë e thuhet:

“Ati shkon një nuse e bukur
kjo s’që nuse po që zërë,
rrinte lart në Mal të Gjërë”

dhe në vargu i njëzet e gjashtë dhe i njëzet e shtatë hasim:

“këto tha zëra dhe shkoi,
Malit Gjërë fluturoi”

Në thelb i gjithë rrëfimi vazhdon me pak ndryshime si në legjendën e murimit, më së shumti e njohur me emrin e kalasë së Rozafës në Shkodër. Vetë ky lloj modifikimi përforcon më tej idenë që edhe balada e Rozafës është në thelb një kanonizim i besimit pagan. Marrim në analizë teksin që na intereson. Së pari hasim konceptin “nuse” që më pas quhet “zëra”. Pra, krah për krah qëndrojnë nusja dhe “zëra”. Kujtojmë në varianten e “Martesës së Mujit” zanat jetojnë dikur me nusen. Në vargje kemi rrinte lart në mal; në këmbë të teksit kemi fusnotën për kroit. Pra, pothuaj kemi një mjedis të ravijëzuar.

Vetë shënimi i dytë(?) poshtë ku thuhet se “në skajin jugor të Malit të Gjerë (në Muzinë) ndodhet një burim që mban emrin topik “Kroi i Zërës””. Ky shënim duhet respektuar për vetë faktin se hasim me një topikë afër ujit apo kroit. Sjellim ndër mend këtu rastin e mësipër përmendur” me ujet e spitharit”.

Mendimi se në këtë rast kemi të bëjmë me një figurë mitologjike përforcohet për faktin se ajo ka fuqi të parashikojë dhe të japë mendime profetike se si bëhen gjërat dhe na tregohet gjithashtu se “Rrinte lart në Mal të Gjërë”.

⁵ Ky përdorim na afron ta shohim emrin “zëra-t” si një emer te gjinise femerore dhe deri në këtë dokumentim apo dhe në dokumentimin e rastit arbëresh zarazi del vetëm femëror dhe deri në këtë dokumentim haset vetëm si emër femëror.

⁶ faqe 698 deri 700 mbledhur ne Gjirokastrë më 1945.

Në këngën⁷ me titull “Moj bejke ballëbërdhëre” në vargun e katërt kemi “del në penxhere si zërë”. Kjo kënge ngjan një rast përkushtimi apo serenate për një vajzë prandaj dhe hiqet paralelja vajzë dhe zërë. Po kështu edhe në këngën ⁸ “O illi që perëndon” (mbledhur në Piqerras-Sarandë) në vargun e pestë “Moj zëra e malevet”. Mali dhe zërat ndodhen këtu jo rastësisht të pranëvendosur.

Në një kënge tjetër ⁹ me titull “O moj borë e bukur” kemi këtë tekst:

O moj borë e bukur,
e bardhë e bukur,
na po bëjmë bukët,
që të marrëm lugët;
të luajmë me topa bore,
si zërat e malit të Çorre. ¹⁰

Karakteristikë e këtij teksti është që në hapje hasim me borën pra kemi një zonë malësie, përforcohet kjo nga mali më tepër. Vetë bora presupozon që nuk është një zonë që rrihet nga jeta e përditshme, pra një mundësi më tepër për mistifikim. Një paralele sinjifikante është që në këtë tekst kemi përkrah motivit me rrethinat tashmë të njohura edhe një motiv të bërjes së bukës ku dihet që ‘zënia e bukës’ në shumë popuj veç praktikës është edhe një ritual. Në motivin tonë bazë hyjnë konceptet “luajnë”, “Zërat e malit”. “Si”-ja në vetvete luan rolin e mos identifikimit kurse përcaktimi për një mal është natyrë tashmë e njohur për këtë figurë.

Në këngën¹¹ me titull “Çila është m’e bukur-o” hasim këtë tekst.

- Diel-o diell-o
çila është m’e bukur-o
që na prishi vallen-o
- Të tria të mira jini,
po si motra e vogël s’jini
shtatin e saj nuk e kini

⁷.kënga 340

⁸ kënga 279

⁹ kënga numer 59 faqe 74

¹⁰ Kënduar nga Kudhësi Bregdetit-Vlore regjistruar më 1946.

¹¹ Kënga 39. f 54 kënduar ne Luzat- Tepelenë 1948

Dhe në fusnotën e dytë kemi këtë shpjegim “Motra e vogël me kërcimin e saj të jashtëzakonshëm i ndezi zilinë edhe vetë “këmbëçalës” (zërës së malit) e cila nga inati që u “thye” (u mund) prej motrës së vogël bëhet shkak i padukshëm për prishjen e valles së tri motrave. Gati hasim këtu një reminishencë që zanat shitojnë dasmorët kupto edhe nusen në rastin e Mujit. Ka të ngjarë që edhe ai rast është një çështje xhelozie. Vargjet që na interesojnë janë:

Ju falëtoje kudo që ini
orë e fatëza ju mirushe:
zëra të maleve e të valeve,
ju bejme duva

Vetë fjala falëtoje nënkupton për dëgjuesin e sotëm altarin në një terminologji shqipe. Në se flasim që altari i përket kishës fjala faltore është më e gjerë dhe në këtë rast mund të themi se kultet bien apo lindin në hije të njëra-tjetrës. Që edhe në këtë rast kemi të bëjmë me një figurë kyesisht malore nënvizohet në konceptin që fjala “valë” nuk shihet nga vendasit e këtyre anëve si valë deti apo diçka e tillë por si valët, disa seri kodrash.

Ia vlen të citohen këtu disa vargje të “Kënga së sprasme e Balës” e Gavril Dara i Riu (Palazzo Adriano, 8 janar 1826 – Porto Empedocle, 15 nëntor 1885) pra nga Sicilia përshtatur nga Shaban Demiraj si më poshtë:

Si ajo mjegula e hollë
Që vërtitet përmbi borë
Plot ndriçim e hijeshi
Porsi Mirëza e Hënës
Ja kështu m’u duk e bukura!

Por hasim edhe: pashë Dreqëzën kaluar
Mbi një rreze hënëtare
Dheun tënd seç më dëftoi,
Dheun tënd, të lumturin;
E në mes të dritës s’ saj
Zbuloi një pamje t’parrëfyer,

Zbuloi një ditë flamurtare
E, mes flamujvet të nderit,¹²¹³

Shtojmë këtu dhe citimin e Anton Berishës “Ndikimi i letërsisë arbëreshe në poemën “Kënga e sprasme e Balës” te Kultura Popullore 1984/2 faqe 92¹⁴ “Në këngën e katërt të pjesës së parë - Vasha e Lalës, përmes mirëzave (që sipas mitologjisë janë vasha hyjnore që bredhin natën nëpër hënë e kërcejnë mbi rreze e mbi ujëra dhe lajmërojnë fatin e mirë)...” Në këtë rast bëhet fjalë për një moshë të kohës së emigrimit të këtij grupi shoqëror rreth shekujve 15-16 kur u larguan. Por veç lidhjes me fjalën mirë, këtu kemi të bëjmë edhe me nuanca të së bukurës; kujtojmë këtu vargun popullor aq të përdorur “moj e mira...” Pra edhe një vlerë estetike për këto figura.

Shpesh në disa dialektete apo gjuhë të ndryshme hasen pjesëza zvogëluese që janë të këtilla por në vetvete përmbajnë përkëdheli, e tillë ngjan të jetë pjesëza -zë në shëmbull popullor fatëza, tek Bala mirëza. Por këtë figurë në popull hasim dhe përcaktimin mirushe ndaj dhe mund të vemë një shenjë barazimi për -(ë)za dhe -ushe.

Një dukuri jo e re është kjo figure ndofta për mbarë letërsinë arbëreshe madje e hasim tek De Rada (Maqi, 29 dhjetor 1814 - *Shën Mitri* 28 shkurt, 1903) në mbledhjet e tij folklorike në këngën me nr 7¹⁵ këto vargje:

Lart, te çuka e një rahji,
Ish një shesh me një arrë.
Atie bridhin zarazit,
Zarazit me dreqëzit;
Bëin e lik po më se mirë.
Ndodhi e vate nd’at’koc
Vasha e padime.
Zarazit e rodhtin,

¹² Dara (i Riu), Gavril “Kënga e sprasme e Balës” poeme transkribuar e përshtatur nga Shaban Demiraj Naim Frashëri Tiranështine 1994 (vargjet nga 62-70) f.169

¹³ Nga vargu 61 hasim këtë tekst në origjinal “Po një natëz u pash/pash Dreqëzën nkaluar/ mbi një rrëmbëz hënëtare me dorëz të bardhë...” te 70.

¹⁴ Kultura Popullore 1984/2 faqe 92

¹⁵ “Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar (1635-1912) I Tiranë 1961 faqe 130-deri 131. (nga Rapsodi të një poemë shqiptare” Këngë popullore të arbreshve të Italisë mbledhur e botuar nga J.DE RADA 1866)

E rodhtin,e mbaitin
Nëntë dit’ e di viet;
Pra mbë shpi njiherie u gjet.
Një trim, pas e pas një zoge,
Holqi njera nd’atë shesh,
Tek dreqëzit mbë rreth
J’u bënë ej e mbaitin
Nëntëdite di viet;
Pra nd’shpi njiherie u gjet.

.....

Më tej ky tekst vazhdon me një ngjarje normale të mundshme. Interesante në këtë pjesë të parë është vetë shënimi në fusnotën nr 2 tek “Mbledhësite e hershëm...1” ku thuhet “prapashtesa zi shtohet më tepër emrave dhe mbiemrave femërore”. Por kyçi i gjithë pjesës është vargu “bëin e lik po më se mirë.” Që në tekste folkorike është interpretuar si bënin mirë më shumë se keq”.

Një dokumentim tjetër që vjen deri në modernitetin e sotëm na vjen nga arbëreshi Carmine Stamile ku na dokumenton në mënyrë më transparente se si mund ta rikrijojmë ‘dreqëzën’ dhe ku e gjemë tjetër: Si na thotë shkrimtari Frangjisk Ndoni Sandori, ndë vepërën e botuar nga Italo Costante Fortino in “Calabria Turismo”, ano IX n° 30, ottobre-dicembre 1976. Pag. 114 Reggio Calabria, Dreqëza, është një “Short fantazme, ose më mirë grua fandasike, me formë të jashtëzakonshme, që banon hone, lera, humnere, prronj, shkrepja dhe vende të shkretë dhe të mbyllët. Besimi popullor e pikturon gjysmë e xhveshur, me flokët e përhapura, me faqen e rrudhët, me sisat e gjata, me kurmin e thatë, të zeshkë dhe nganjëherë të qartë dhe të tejdukshëm, sipas kohës kur fanitet. Ajo fanitet më se më në qendrën e ditës, menatet heret, dhe mbrëmanet në sjelljen e të lajturir cohëza, ose në shprehje të tjera dhe në sjellje jo të frikshme; prandaj mbahet për xhind tekanjoz. por jo të keq. I jepet për gaz, gravet të bukura kur dëshirohet t’i përçmojë, dhe gravet me të vërtetë budallaqe, të shëmtuara dhe të ndyra”. Edhe sod, ndë katundin tënë, shumë gjindë mbain mendë (kuitoïn) Dreqëzën e thonë se ish një grua e vogël më një koshinë e madhe. Dil ndë lumra, ku grat vejin të lajin, me nië gur i artë ndën sjetulla, po sa shih gjindë

ikij, pëse trëmbej sei i mirrëjin gurin. Thuhet edhe se ‘Dreqeza ish e shoqja e djallit’¹⁶.

Çabej është ndër studiuesit shqiptarë, me aq sa njohim deri më sot, i pari që ka vënë re këtë dukuri të zanave në Veri të zonave shqipfolëse me zërat në Jug të tyre në artikullin “Per gjenesën e lieteraturës shqipe-Themelet Kulture-historike: Populli dhe poezia e tij” në nënndarjen “Karakteret konservativ të zonave malësore të anëve” për këtë arsye po e citojme shmebullin që jep ai¹⁷. “Vajza e malit dhe ndihmësja në luftë zâna e shqipërisë Veriore, e cila rron edhe ndër Rumunë e Arumunë dhe origjina e së cilës prej lat. Diana mbetet e dyshimtë si zërë, më pardduket “Fee” tani “Vajzë e bukur” në katundet rreth Vlorës (Tragjës, Dukat, Radhimë) dhe në Himarë. Këtu këndohet kjo këngë:

“Eja posht’ o zërë!”
 “Vijte po s’ më lënë
 Më thon: ku ke qënë?”
 “Në Demush në lëmë.”
 “Ku ke qën’ o ngjallë?”
 “Atje tek një djalë;
 Ai s’ qe një djalë
 Po qe rrënje-dalë.
 Më puthi në ballë
 Shoqetë më panë
 “Ç’bën ati?” më thanë.
 “Puthem me jaranë”
 • jaran jaran më ruash,
 Në do me mua të luash,
 Puthm e ndukëm sa të duash,
 Po mos dëfto e mos thuash.”

Rasti i mësipërm është një shëmbull i kalimit nga theksimi i anës se bukur në një përdorim artistik poetik. Por s’ duhet harruar që dashuria mbart në vetvete edhe një moment magjizmi, pra tek e fundit ka një lidhje të veçantë edhe për figurën në fjalë.

Duke u kthyer sërish në përmbledhjen tonë hasim në këngën “E keqja te prapsojë”¹⁸ hasim këto vargje:

¹⁶ Stamile, Carmine Vjeshe popullore (canti popolari) *Orizzonti Meridionali* 2013 f.17

¹⁷ Çabej Eqrem “Studime gjuhësore” Vëll. V Rilindja Redaksia e botimeve Prishtinë 1975 faqe 112

¹⁸ në këngën nr 27, faqe 41

“Me emër të zotit,
me ndihmë të Baba-Tomorrit,
të zërave të malit*
e keqja të prapsojë
të shkojë e të mënojë,
shtatë male të kaptojë
Të shtatë motra zërat,
me shtatë fshesa të arta:
një fshij synë
një fshij gjakun
një fshij...”

Që nga Rilindja e këtej, mali i (Baba)-Tomorrit mbetet vend i shenjtë e më tej kalon si i tillë për njërin nga religjionet. Ndër të tjera këtij të fundit dhe figurës sonë i kërkohet të ndihmojnë dhe të ndikojnë. Në shënimin e fusnotes kemi “Besohej se shtatë zëra në shtatë male ndërhyjnë dhe e shëronin të sëmurin duke kryer secila detyrën e saj.”

Në këngën e 18-të me titull “O moj za e malit”:

O moj za e malit
moj zëra e Kroit valit
bjemë qumështin e djalit
se më qan ëështë çilimi
qan e qan e bën figan
s’e mësoj dot me tigan.

Përfundime

Dhe si mbyllje le të nxjerrim disa përfundime për rastet e shqyrtuara më sipër. Së pari një vështrim gjuhësor mund ta nisim me:

“Krijimi i kësaj kundërvënije është përfutur qysh në atë periudhë kur në të folmet jugore vepronte ndërrimi i -n- ndërzanore në -r-. Kjo dukuri, që ka përfshirë rregullisht fjalët e trashëguara dhe huazimet latine duhet të ketë pushuar së vepruari para depertimit të sllavizmave në gjuhë shqipe, d.m. th. jo më vonë se shekujt VII-VII të erës sonë” (I/113 faqe 152)¹⁹.

¹⁹ Shënimi i mësipërm nxjerrë nga: Demiraj, Shaban “Gramatike historike e gjuhës shqipe” “8 Nëntori” Tiranë 1985

Ky citim është shumë domethënës për një moshë relative të kësaj fjale e njëkohësiht të kësaj figure. Për ta ritheksuar e sqaruar më tej citojmë po nga e njëjta vepër:

“Kështu p.sh., duke u mbështetur në faktin që rotacizmi i të folmeve jugore, në përgjithësi, nuk ndeshet në huazimet sllave por ndeshet në huazimet latine, është arritur në përfundimin e drejtë që kjo dukuri ka pushuar së vepruari para depërtimit të sllavizmave në shqipe d. m. th për afërsisht para shekujve VII-VIII. Si rrjedhim një dukuri gramatikore e shqipes që i është nënshtruar rotacizmit duhet të jetë përfunduar para këtij caku kohor. I tillë është p.sh rasti i prapangjitjes së nyjes së prapme; khs zan-i /zër-i, mullini-i mullir-i etj” (faqe 30)

Pra përmbledhtazi mund të themi se hasim një shkallë të parë, zana për nga ana gjuhësore ka pësuar shndërrimin zëra (procesi i rotacizmit) që mund të datohet të paktën nga shekulli i 6 deri i 7. Brenda procesit gjuhësor hasim një afri morfologjike: të dy janë emra të gjinisë femërore, parë edhe nga përdorimi i derisotëm i tyre. Ky kalim i anës gjuhësore mbështetet edhe nga një seri afrish të tjera. Hasim afri të emërtimit zana/zëra. Hasim afri të rrethinës, pra haset pranë fjalëve mal, kodër (në formën dialektore: valë) apo edhe pranë një burimi me ujë. Hasim gjithashtu afri të veprimit lodroj/luaj; japin gjë etj. Afri tjetër që hasim është ajo e konteksteve mitologjike.

Më tej hasim një shkallë të dytë zëra qaset më zarazi. Në këtë rast hasim afri të emërtimit i cili daton historikisht rreth shekullit të 15 me largimin e arbëreshëve për në Itali. Hasim afri gjuhësore morfologjike ku hasim psh në rastin kur në toskërisht sot mirushe (prapashtesa -ushe) në arbërisht mirëza (prapashtesa në arbërisht -za)

Kështu edhe tek fjala zarazi duhet të kemi një nuancë të kësaj prapashtese me formën -zi që u shtohet emrave të gjinisë femërore.

Nga ana gjuhësore trajta arbëreshe ruan formën më arkaike (krahaso zana) në rastin e a-së por ka pësuar transformimin e rotacizmit, pra është e ardhur nga varianti i jugor i fjalës “zëra”.

Kemi afri të kontekstit figurë mitologjike popullore dhe të shfaqjes në tekste popullore këngësh me natyrë mitologjike zëra-zarazi. Kemi afri të rrethinës. Hasim afri të veprimit.

Në një stad të mëtejshëm hasim një shakallë të tretë të përjasjes zana-zëra-zarazi. Kemi afri të emërimit me një rrënjë za plus transformime të -n-ës në r-ë. Si edhe kalimë të –a-së drejt një errësimëi në –ë. Dhe vazhdim tek një -a, më pas. Kjo na jep dorë për një farë datimi të proceseve. Pra errësimi i i a-së duhet të këtë ndodhur pas shekullit të 14-15.

Kemi afri morfologjike sepse hasen si emra të gjinisë femërore, në të tre rastet. Hasim një afri rrethine ku kjo figurë gjendet gjithmonë në afërsi të një Mali-lart në mal/valëve (me kuptimin kodër) - rah (me kuptimin kodër). Lug (në kuptimin pranë një burim uji) - spithari (pranë një vendi me ujë) shesh (pranë një peme, që ndoshta jep nuancën e lagështisë) - ndrin (haset shpesh në epos kur del zana një shfaqet një dritë) - ndriçim (pranë fjalës vetëtimë për ta bërë më të besueshme). Kemi paralelen tjetër (Mujit i rrëmbehet) nusja - shpesh ka të bëjë me një) nuse, (apo haset) vajzë. Kemi afri të veprimit lodrojnë (kujto këtu edhe rastin e vjershës së Luka Bogdanit²⁰) - lujanë - në rreth/bridhin. Një linjë tjetër është shitojnë (zanat) -.....- mbaitin/rodhtin. Mujin zanat e mëkojnë me qumësht gjiri- kurse te zërat hasim “japin gj”.

Së fundi, mund të shprehemi se të fshehtat e shpirtit shqiptar po fillojnë të hapen edhe pse pas një vonese prej shekujsh. Këtu vetëm sa gërvishtëm një thesar ende të pazbuluar mirë. Mund të formulojmë se është arkeologji filologjike. Për rrjedhojë, duhet të vëmë në dukje se interpretimi i gjetjeve fillimisht konsiston në gjetjen e materialit. Dhe atëherë nëse gjetjet dhe interpretimet mbështesin njëra-tjetrën, nëse interpretimet e hartuara nga fusha të papritura të letërsisë folklorike gjejnë konfirmim vazhdimisht, nëse e gjithë kjo është e mbështetur dhe tepër logjike për të qenë në gjendje ta hedhim poshtë në mënyrë bindëse si një akumulim rastësish, atëherë mund të supozohet se, një zë nga thellësia e kohës na thërret. Megjithatë, duke pasur parasysh besueshmërinë e treguar, çdo përfundim duhet të kontrollohet vazhdimisht dhe vlefshmëria e tij të vlerësohet në dritën e të gjithë kompleksit. Materiali burimor nuk është shteruar. Vetëm në këtë mënyrë mund të bëhen më të qarta dhe më të besueshme veçoritë e pamjes, e cila kaq papritur ka filluar të shfaqet.

²⁰ Mato, Martin (2010) ”Rituali i pare pagan i dokumentuar ne Kosove” në “Albanica” nr 93; janar-shkurt f 34-37 Prishtinë 2010

BIBLIOGRAFI

Referime artikujsh:

MANDALA, M shih <https://exlibris.al/mbi-odisene-e-veprave-te-francesk-anton-santorit-dhe-problemet-ekdotike-per-botimin-e-tyre/> (gjendja 10.12.2022)

MATO, M. (2001) "Epos und Mythologie" në "Albanien Reichtum und Vielfalt alter Kultur" München

MATO, M. (2010) "Rituali i pare pagan i dokumentuar ne Kosove" në "Albanica" nr 93; f. 34-37 Prishtinë

Referime librash

DARA, GAVRIL (I RIU) (1991) "Kënga e sprasme e Balës", Sh. B "Naim Frashëri" Tiranë

ÇABEJ EQREM (1975) "Studime gjuhësore" Vëll. V Rilindja Prishtinë.

DEMIRAJ, SH. (1985) "Gramatike historike e gjuhës shqipe", "8 Nëntori" Tiranë

FATOS M R. (1991), 'Këngë popullore të Labërisë' Mbledhës të folklorit 8 Tiranë.

SANTORI, F.A.(1975) 'Il canzonere albanese' Rradhonjtë e zjarrit

STAMILE, C. (2013) Vjeshë popullore (canti popolari) Orizzonti Meridionali